



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 150/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 28.04.2020 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave lidhur me skualifikimin e operatorit ekonomik “Vale Recycling” shpk nga procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozim” me Nr. REF-49691-02-06-2020, me objekt: “Sherbimi i Evadimit të mbetjeve të rrezikshme spitalore për Spitalin Sarandë, për 12 muaj”, me fond limit 1,750,000 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 17.02.2020, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Sarandë.

Ankimues: “Vale Recycling” shpk
Adresa: Fushë Kuqe, Gurrëz afër ish kanalit të acidit Lezhë.

Autoriteti Kontraktor: Drejtoria e Shërbimit Spitalor Sarandë.
Adresa: Rruga “Onhezmi”, Lagjia Nr. 3, Sarandë.

Subjekte të Interesuara: “Medi Tel” shpk
Adresa: Autostrada TR-DR, Km.1, Rruga “Vidhe Gjata”, Nr.18 Tiranë.

“Pura Medical” shpk
Adresa: Ish Reparti i Kipit të Furrnaltës, Kombinati Metalurgjik Elbasan.

“Eko Riciklim” shpk
Adresa: Kashar, Lagjia “Mezez”, Rruga Dytesore Kashar Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, pretendimet e tij dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky operator ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

I.3. Operatori ekonomik ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë Autoritetit Kontraktor si dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 07.02.2020 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozim” me Nr. REF-49691-02-06-2020, me objekt: “Shërbimi i Evadimit të mbetjeve të rrezikshme spitalore për Spitalin Sarandë, për 12 muaj”, me fond limit 1,750,000 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 17.02.2020, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Sarandë.

II.2. Në datën 17.02.2020, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 20.02.2020 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

1. “Medi-Tel” shpk	1,694,000 lekë	skualifikuar
2. “Vale Recycling” shpk	1,715,000 lekë	skualifikuar
3. “Pura Medical” shpk	1,715,000 lekë	skualifikuar
4. “Eco Riciklim” shpk	1,750,000 lekë	skualifikuar

II.4. Në datën 21.02.2020, operatori ekonomik “Vale Recycling” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për riklasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me arsyen se:

Oferta refuzohet sepse:

a. Nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues për plotësimin e kriterit nr 5 të kualifikimit - përsa i përket kapacitetit teknik. Operatori ka paraqitur një kontratë për dorëzimin e mbetjeve urbane në landfillin e Bushatit i cili administrohet nga operatori ekonomik “Ndërkomunale Bushat” SHA. Kontrata me nr 55 prot. datë 21.03.2019. Subjekti “Ndërkomunale Bushat” SHA nuk ka leje mjedisore për ushtrimin e aktivitetit të vend depozitimit të mbetjeve por ka një kontratë shërbimi të lidhur me 28.04.2017 me operatorin ekonomik “BECKER Albania” SHA. Kontrata e shërbimit e datës 28.04.2017 nuk është e noterizuar dhe nuk plotëson kriterin e vendosur nga AK që dokumentacioni i dorëzuar nga ana e operatorëve ekonomike për pjesmarrje në një procedurë prokurimi duhet të jetë origjinale ose kopje e noterizuar. Gjithashtu leja mjedisore PN 1234 -12- 2010 me kodin III.1.B, që posedon operatorin ekonomik “BECKER Albania” SHA, është lëshuar në datën 29.12.2010 ne bazë të ligjit nr. 8934 datë 05.09.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit” i cili është shfuqizuar dhe në bazë të ligjit Nr 10431, datë 09.06.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, Ligjit Nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për manaxhimin e integruar të mbetjeve”, VKM Nr. 99 datë 18.02.2005 “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”, VKM nr. 452 datë 11.07.2012 “Për landfildet e mbetjeve”, Ligjit Nr. 10448 date 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, instalimet ekzistuese të landfillit në fjalë duhet të kishin kryer procedurën për rishikimin e kushteve të lejes ekzistuese të mjedisit (PN 1234 -12- 2010), gjë që nuk dokumentohet me ndonjë material shkresor nga ofertuesi “VALE RICYKLING” shpk.

Si konkluzion , operatori ekonomik “VALE RICYKLING” shpk nuk përmbush kërkesën e pikës 5 të kriterëve teknike të kualifikimit të përcaktuara nga AK sipas nenit 46 të VKM 914/2014 (kualifikimi i ofertave) pika 1.

Për sa më sipër komisioni i vlerësimit të ofertave vendosi të rishikojë edhe një herë vlerësimin e kësaj oferte të bërë më datën 20.02.2020 dhe të mos e pranojë edhe ofertën e operatorit ekonomik “V.A.L.E. RICYKLING” shpk dhe ta skualifikojë atë.

II.4.1. Në datën 27.02.2020, operatori ekonomik “Vale Recycling” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor ku kundërshton vendimin e KVO-së lidhur me skualifikimin e tij nga kjo procedurë prokurimi në mënyrë të përmbledhur me argumentet si më poshtë vijon:

Pasi morem pjese ne proceduren objekt i kesaj ankese, me date 20.02.2020, u njoftuam ne SPE per rezultatet e vleresimit te ofertave nga KVO si vijon:

<i>Operatoret Ekonomike</i>	<i>Vlera e ofertuar</i>	<i>Refuzuar</i>
<i>MEDI -TEL</i>	<i>242</i>	<i>Po</i>
<i>V.A.L.E. RECYCLING</i>	<i>245</i>	<i>Jo</i>
<i>PURA-MEDICAL</i>	<i>245</i>	<i>Po</i>
<i>ECO RICIKLIM</i>	<i>250</i>	<i>Po</i>

Me date 21.02.2020, u njoftuam ne SPE per rivleresim te ofertave me rezultat te rivleresimit si vijon:

<i>Operatoret Ekonomike</i>	<i>Vlera e ofertuar</i>	<i>Refuzuar</i>
<i>MEDI -TEL</i>	<i>242</i>	<i>Po</i>
<i>V.A.L.E. RECYCLING</i>	<i>245</i>	<i>Po</i>
<i>PURA-MEDICAL</i>	<i>245</i>	<i>Po</i>
<i>ECO RICIKLIM</i>	<i>250</i>	<i>Po</i>

Ne i kundërshtojme rezultatet e ketij rivleresimi me argumentat ne vijim:

Ne mesazhin e arsyeve te skualifikimit ne po te njejtën date 21.02.2020, na behet me dije se jemi skualifikuar me arsyet si vijon:

Oferta refuzohet sepse: a. Nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues për plotësimin e kriterit nr 5 të kualifikimit - përsa i përket kapacitetit teknik. Operatori ka paraqitur një kontratë për dorëzimin e mbetjeve urbane në landfillin e Bushatit i cili administrohet nga operatori ekonomik “Ndërkomunale Bushat” SHA. Kontrata me nr 55 prot. datë 21.03.2019. Subjekti “Ndërkomunale Bushat” SHA nuk ka leje mjedisore për ushtrimin e aktivitetit të vend depozitimit të mbetjeve por ka një kontratë shërbimi të lidhur me 28.04.2017 me operatorin ekonomik “BECKER Albania” SHA. Kontrata e shërbimit e datës 28.04.2017 nuk është e noterizuar dhe nuk plotëson kriterin e vendosur nga AK që dokumentacioni i dorëzuar nga ana e operatorëve ekonomike për pjesmarrje në një procedurë prokurimi duhet të jetë origjinale ose kopje e noterizuar. Gjithashtu leja mjedisore PN 1234 -12- 2010 me kodin III.1.B, që posedon operatorin ekonomik “BECKER Albania” SHA, është lëshuar në datën 29.12.2010 ne bazë të ligjit nr. 8934 datë 05.09.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit” i cili është shfuqizuar dhe në bazë të ligjit Nr 10431, datë 09.06.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, Ligjit Nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për manaxhimin e integruar të mbetjeve”, VKM Nr. 99 datë 18.02.2005 “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”, VKM nr. 452 datë 11.07.2012 “Për landfildet e mbetjeve”, Ligjit Nr. 10448 date 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, instalimet ekzistuese të landfillit në fjalë duhet të kishin kryer procedurën për rishikimin e kushteve të lejes ekzistuese të mjedisit (PN 1234 -12- 2010), gjë që nuk dokumentohet me ndonjë material

shkresor nga ofertuesi “VALE RICYKLING” shpk. Si konkluzion, operatori ekonomik “VALE RICYKLING” shpk nuk përmbush kërkesën e pikës 5 të kriterëve teknike të kualifikimit të përcaktuara nga AK sipas nenit 46 të VKM 914/2014 (kualifikimi i ofertave) pika 1. Për sa më sipër komisioni i vlerësimit të ofertave vendosi të rishikojë edhe një herë vlerësimin e kësaj oferte të bërë më datën 20.02.2020 dhe të mos e pranojë edhe ofertën e operatorit ekonomik “V.A.L.E. RICYCLING” shpk dhe ta skualifikojë atë.

Nga mesazhi i mesiperm, rezulton qarte se rivlerësimi është bërë pasi KVO pretendon që nga ana jone nuk plotësohet pika 2.3.5 e Shtojcës 7. Kjo arsye skualifikimi nuk qëndron. Për qartësi, kjo pikë lexon si vijon:

5. Dokumentacion se pas trajtimit të mbetjeve spitalore (sterilizimit me autoklave) dhe incenerator operatori i dorezon mbetjet e trajtuara në landfill për këto qëllime duhet të dorezojë:

- a) kontratën me landfillin e licensuar ose faturën e leshuar nga landfilli për vitin 2019.
- b) pagesën e kryer ndaj landfillit ku depoziton mbetjet nga aktiviteti për vitin 2019.

Për qëllimi i këtij kriteri është që AK të sigurohet që pasi mbetjet të perpunohen/asgjësohen në impiantin e autoklaves dhe/ose incenerimit, produkti i mbetur nga procesi i autoklavimit dhe/ose incenerimit, që konsiderohet mbetje e parrezikshme pas trajtimit, të depozitohet evadohet sipas të gjitha rregullave dhe ligjeve në fuqi.

Për përmbushjen e këtij kriteri në kemi paraqitur kontratën perkatese me landfillin perkates që pranon për landfillim mbetjet/produktet që dalin nga perpunimi në impiantin të mbetjeve spitalore. Me konkretisht në kemi depozituar në SPE:

A) Dokumentin “Kontrata landfilli dhe leje Becker pdf” me 27 faqe, që përbehet nga:

- 1. Kontrata e lidhur nga “V.A.L.E Recycling” sh.p.k me “Nderkomunale Bushat” sh.a. nr. 55, datë 21.03.2019.
- 2. Kontrata ndërmjet “Nderkomunale Bushat” sh.a dhe shoqërisë “Becker Albania” sh.a datë 28.04.2017 ku “Nderkomunale Bushat” si pronar i landfillit të Bushatit, angazhon “Becker Albania” që është i pajisur me Leje Mjedisore, si operator i landfillit të Bushatit. Në këtë kontratë, në pjesën Preambulë, në pikën iv është përcaktuar që: “ish Këshilli i Komunes Bushat, (sot Bashkia Vau Dejës) si aksionar i vetëm i Porositësit”, me Vendimin Nr. 25 datë 11.06.2010 ka miratuar dënimin në përdorim të landfillit të Komunes Bushat shoqërisë “Becker Albania” sh. a dhe ka autorizuar lidhjen e kontratës perkatese për realizimin e shërbimeve të depozitimit, administrimit, menaxhimit, perpunimit dhe riciklirimit të mbetjeve”.
- 3. Leja Mjedisore dhe Akt Miratimi perkates Nr. PN-1234-12-2010, e leshuar për shoqërinë “Becker Albania” për operimin e vend depozitimit të mbetjeve (landfillin) të Bushatit,

B) Dokumentin “Pagesa Landfilli pdf”, me 1 faqe ku konfirmohet pagesa kryer ndaj Landfillit gjatë vitit 2019.

Nga sa me siper duket qarte se kriteri i vendosur nga AK, jo vetem eshte permbushur, por dokumentacioni i paraqitur tejkalon edhe vete kerkesat e AK, pasi provon me dokumentacion te gjithë zinxhirin e mbulimit te ketij kriteri. Argumentat tona jane si vijon:

1. Ne funksion te permbushjes se ciklit te kontratave ku jemi angazhuar si pjese e aktivitetit tone dhe ne permbushje te kerkesave ligjore, qe nga viti 2015 si shume shoqeri te tjera qe operojne ne kete fushe, kemi lidhur kontrate me shoqerine “Nderkomunale Bushat” sh.a, e cila ka ne pronesi Landfillin e Bushatit, te cilin e operon nepermjet shoqerise “Becker Albania” sh.a., per depozitim ne kete landfill te mbetjeve urbane dhe te produktit te pademshem qe del nga perpunimi i mbetjeve spitalore.

“Nderkomunale Bushat” sh.a. qe eshte nje shoqeri publike me aksioner te vetem vete Bashkine Vau i Dejes, mbikeqyret nga Keshilli Mbikeqyres qe perbehet nga anetare te Bashkise Vau i Dejes, Shkoder dhe Lezhe dhe Ministrise se Infrastruktures, ka ne pronesi vend depozitim e mbetjeve te Bushatit dhe ne objektin e veprimtarise se saj ka percaktuar qe do te mbuloje Qarkun e Shkodres dhe nje pjese te Qarkut te Lezhes ku perfshihet dhe vendi i ushtrimit te aktivitetit te “V.A.L.E Recycling”. Vete Bashkia Vau i Dejes, me Vendimin e Keshillit Bashkiak Nr.25 date 11.06.2010, ka autorizuar qe per operimin e landfillit, Nderkomunale Bushat te angazhoje shoqerine “Becker Albania” (Shiko fq. 14, 15 te dokumentit “Kontrata Landfilli dhe leje Becker pdf” te paraqitur ne SPE. Theksojme se nga ana jone jane paguar rregullisht tarifat e miratuara cdo vit nga Bashkia Vau i Dejes per kete sherbim, te cilat jane arketuar si te ardhura te pushtetit vendor. Edhe pse nuk eshte kerkuar ne dokumentat e tenderit, ne pervec kontrates se lidhur mes ketyre dy subjekteve kemi paraqitur edhe Lejen Mjedisore perkatese te “Becker Albania” me Nr. PN- 1234-12-2010. Ju kujtojme me kete rast se nga ana e AK Spitali Sarande ne piken 2.3.5 te kriterëve nuk eshte kerkuar qe ne te paraqesim edhe Lejen e Landfillit, por vetem Kontraten e lidhur nga ne me landfillin, por sidoqofte ne e kemi paraqitur lejen sic ka qene pjese e kontrates kur eshte lidhur nga ana jone.

2. Nga ana e KVO pretendohet se: “Ne baze te ligjit nr. 8934 date 05.09.2002 “Per mbrojtjen e mjedisit” i cili eshte shfuqizuar dhe ne baze te ligjit Nr. 10431 date 09.06.2011, “Per mbrojtjen e mjedisit”, Ligjit Nr. 10463, date 22.09.2011 “Per manaxhimin e integruar te mbetjeve”, VKM Nr. 99 date 18.02.2005 “Per miratimin e katalogut shqiptar te klasifikimit te mbetjeve”, VKM Nr. 452 date 11.07.2012 “Per landfillet e mbetjeve”, Ligjit Nr. 10448 date 14.07.2011 “Per lejet e mjedisit”, instalimet ekzistuese te landfillit ne fjale duhet te kishin kryer proceduren per rishikimin e kushteve te lejes ekzistuese te mjedisit (PN 1234 -12- 2010), gje qe nuk dokumentohet me ndonje material shkresor nga ofertuesi.

Se pari sqarojme, se ne kriteret e publikuara ne Dokumentat e Tenderit (pika 2.3.5) nuk eshte kerkuar qe ofertuesit ta paraqesin lejen e mjedisit te landfillit apo ndonje dokumentacion qe te provoje se landfilli ka kryer proceduren per rishikimin e kushteve te lejes se mjedisit. Megjithate, pavaresisht nga kjo, ne e kemi depozituar Lejen e Mjedisit te operatorit te Landfillit sic ka qene pjese e kontrates qe ne kemi lidhur me “Nderkomunale Bushat” sh.a.

Se dyti sqarojme se arsyeja juaj e skualifikimit i referohet Ligjit Nr. 10448 date 14.07.2011 “Per Lejet e Mjedisit” qe eshte botuar ne Fletore Zyrtare ne 5 Gusht 2011 dhe ka percaktuar

qe hyn ne fuqi 18 muaj pas botimit ne Fletore Zyrtare, pra ka hyre ne fuqi ne 5 Shkurt 2013. Sipas nenit 30 të këtij ligji operatorët e instalimeve ekzistuese para hyrjes ne fuqi te ligjit kane pasur detyre qe te bejne perputhshmerine me ligjin e ri brenda 8 vjetëve nga hyrja ne fuqi, pra brenda dates 5 Shkurt 2021, duke paraqitur per kete qellim ne AKM kerkesen per rishikim te kushteve te Lejes dhe Planin e Perputhshmerise me afatet perkatese. Nderkohe deri ne daten 5 Shkurt 2021 keta operatore jane lejuar te operojne me lejet ekzistuese deri ne miratimin e lejeve te rishikuara nga AKM, gjithmone brenda afatit 5 Shkurt 2021.

Se treti sqarojme se ne menyre te posacme per landfillet e mbetjeve, ceshtja e landfilleve ekzistues eshte rregulluar me pikat 25, 26, 28 dhe 29, te kreut XI te VKM nr 452 date 11.07.2012 “Per landfillet e mbetjeve”, e cila eshte permendur nga ana juaj. Por nuk eshte permendur nga ana juaj qe kjo VKM nr. 452, eshte ndryshuar me VKM Nr. 389, date 27.6.2018 “Per disa ndryshime dhe shtesa ne Vendimin Nr. 452, date 11.7.2012, te Keshillit te Ministrave “Per Landfillet e Mbetjeve” e cila ka bere ndryshime. Pra, duket qarte nga pikat 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31 dhe 32 te VKM nr. 452 date 11.07.2012 “Per landfillet e mbetjeve” ndryshuar me VKM Nr. 389, date 27.6.2018 se landfillet ekzistuese, te pajisur ose jo me Leje Mjedisore (madje ne rastin e Bushatit behet fjale per landfill te pajisur me leje mjedisore), jane ende brenda periudhes se lejuar per te operuar rregullisht duke pershtatur kushtet e tyre me kerkesat e VKM nr. 452 date 11.07.2012 dhe kjo periudhe vazhdon lirisht deri ne 31.12.2018 edhe per ato landfille qe skane fare leje mjedisore. Sidoqofte, VKM ne fjale ka percaktuar qe afati fundor per pajisjen e landfilleve ekzistuese qe skane leje, me leje mjedisore apo per rishikimin e lejes mjedisore per ata qe e kane eshte data 31 dhjetor 2020.

Se katerti, nga VKM e sipercituar eshte e qarte landfilli i Bushatit, i ka permbushur kerkesat e kesaj VKM me se miri dhe ka qene i lejuar per te operuar, perndryshe per te do te ishte aplikuar pika 31 e VKM nr. 452 date 11.07.2012 “Per landfillet e mbetjeve” ndryshuar me VKM Nr. 389, date 27.6.2018 dhe ky landfill do te ishte mbyllur.

E kunderta ne fakt eshte e vertete. Pikerisht me date 24.02.2020 eshte miratuar ne menyre perfundimtare Leja Mjedisore me kushtet e rishikuara te operatorit te Landfillit te Bushatit (Becker Albania), e cila madje rezulton se eshte miratuar para perfundimit te afatit fundor (31 dhjetor 2020), pra qe konfirmon se gjate kesaj kohe landfilli i Bushatit i ka permbushur te gjitha kerkesat e VKM nr. 452 date 11.07.2012 “Per landfillet e mbetjeve” ndryshuar me VKM Nr. 389 date 27.06.2018. Kjo Leje Mjedisore (qe gjendet ne faqen e QKB), konfirmon qarte se Landfilli i Bushatit ka operuar dhe vijon te operoje duke permbushur te gjitha kerkesat e VKM nr. 452 date 11.07.2012 “Per landfillet e mbetjeve” ndryshuar, dhe ka paraqitur te gjitha planet e perputhshmerise dhe permirisimit brenda afateve te percaktuara, per ndryshe nuk do te ishte pajisur rregullisht me Lejen Mjedisore me te fundit.

Sido qofte, kjo ceshtje identike eshte zgjidhur njehere nga KPP me Vendimin nr. 329/2019, serish ne baze te nje ankese te paraqitur nga operatori ekonomik “MEDI-TEL”, dhe KPP ne kete Vendim eshte shprehur se pretendimi i operatorit ekonomik “MEDI –TEL” shpk, nuk qendron.

Thene sa me siper, rezulton se AK, na ka skualifikuar pa te drejte, dhe jo vetem ka ngritur pretendime qe nga ana jone te ishin paraqitur dokumenta qe s'jane kerkuar, por ka neglizhuar ne shqyrtimin e bazes ligjore, ndryshime te rendesishme qe e qartesojne shume mire situaten ne lidhje me ligjshmerine e operimit te Landfillit te Bushatit.

Ne konkluzion, duke u nisur nga sa me siper, kerkojme shqyrtimin e ankeses sone dhe rivleresimin perkates, duke na kualifikuar dhe duke e pranuar oferten tone si te vlefshme.

II.4.2. Me shkresën Nr. 314 prot, datë 02.03.2020 autoritetit kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues, i cili ka marrë njoftim nëpërmjetë shërbimit të Postës Shqiptare më datë 05.03.2020, e vërtetuar kjo nëpërmjetë barkodit RR974647998AA, ku ka vendosur mospranimin e ankesës së tij.

II.4.3. Në datën 17.03.2020, operatori ekonomik ankimues “Vale Recycling” shpk, ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt ankese si në autoritetin kontraktor.

II.5. Nëpërmjet shkresës nr. 438 prot., datë 24.03.2020, protokolluar me tonën me numër 308/2 prot., datë 27.03.2020, me objekt “Informacion” është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Vale Recycling” sh.p.k, mbi skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me arsyen: “Nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues për plotësimin e kriterit nr 5 të kualifikimit - përsa i përket kapacitetit teknik. Operatori ka paraqitur një kontratë për dorëzimin e mbetjeve urbane në landfillin e Bushatit i cili administrohet nga operatori ekonomik “Ndërkomunale Bushat” SHA. Kontrata me nr 55 prot. datë 21.03.2019. Subjekti “Ndërkomunale Bushat” SHA nuk ka leje mjedisore për ushtrimin e aktivitetit të vend depozitimit të mbetjeve por ka një kontratë shërbimi të lidhur me 28.04.2017 me operatorin ekonomik “BECKER Albania” SHA. Kontrata e shërbimit e datës 28.04.2017 nuk është e noterizuar dhe nuk plotëson kriterin e vendosur nga AK që dokumentacioni i dorëzuar nga ana e operatorëve ekonomike për pjesmarrje në një procedurë prokurimi duhet të jetë origjinale ose kopje e noterizuar. Gjithasht leja mjedisore PN 1234 -12- 2010 me kodin III.1.B, që posedon operatorin ekonomik “BECKER Albania” SHA, është lëshuar në datën 29.12.2010 ne bazë të ligjit nr. 8934 datë 05.09.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit” i cili është shfuqizuar dhe në bazë të ligjit Nr 10431, datë 09.06.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, Ligjit Nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për manaxhimin e integruar të

mbetjeve”, VKM Nr. 99 datë 18.02.2005 “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”, VKM nr. 452 datë 11.07.2012 “Për landfildet e mbetjeve”, Ligjit Nr. 10448 date 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, instalimet ekzistuese të landfillit në fjalë duhet të kishin kryer procedurën për rishikimin e kushteve të lejes ekzistuese të mjedisit (PN 1234 -12- 2010), gjë që nuk dokumentohet me ndonjë material shkresor nga ofertuesi “VALE RICYKLING” shpk. Si konkluzion , operatori ekonomik “VALE RICYKLING” shpk nuk përmbush kërkesën e pikës 5 të kriterëve teknike të kualifikimit të përcaktuara nga AK sipas nenit 46 të VKM 914/2014 (kualifikimi i ofertave) pika 1. Për sa më sipër komisioni i vlerësimit të ofertave vendosi të rishikojë edhe një herë vlerësimin e kësaj oferte të bërë më datën 20.02.2020 dhe të mos e pranojë edhe ofertën e operatorit ekonomik “V.A.L.E. RICYCLING” shpk dhe ta skualifikojë atë ”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 7, “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit”, pika 2.3.5 “Kapaciteti teknik” në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

5. Dokumentacion se pas trajtimit të mbetjeve spitalore (sterilizimit me autoklavë) dhe incenerator operatori i dorëzon mbetjet e trajtuara në landfill për këtë qëllim duhet të dorëzojë:

- a) kontratën me landfillin e licensuar ose faturat e lëshuara nga landfilli për vitin 2019.
- b) pagesën e kryer ndaj lanfillit ku depoziton mbetjet nga aktiviteti për vitin 2019.

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në Sistemin e Prokurimeve Elektronikë (SPE), konstatohet se operatori ekonomik ankimues “Vale Recycling” sh.p.k., për plotësimin e kriterit të mësipërm, ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

1- Leje Mjedisore Kodi III.2.B për aktivitetin grumbullim, transport, ruajtje dhe asgjësim i mbetjeve spitalore (nga kujdesi shëndetsor njerëzor dhe shtazor) në emër të Vale Recycling. Akt Miratimi Leje Mjedisore Nr. 6336 datë 24.07.2018.

2- Leje Mjedisore Kodi III.1.C, Leje Mjedisore e Tipit A për aktivitetin incenerim i mbetjeve të rrezikshme në një instalim incenerim, në emër të Vale Recycling. Akt Miratimi Leje Mjedisore Nr.936 datë 31.01.2019.

3- Kontratë Nr. 55 prot datë 21.03.2019 lidhur ndërmjet Ndërkomunale Bushat sha dhe Vale Recycling shpk . Shoqëria dhe Klienti dëshirojnë të hyjnë në një marrëdhënie kontraktuale në të cilën shoqëria pranon të depozitohen beturinat urbane të praueshme në landfill nga ose në emër të klientit dhe klienti do të lëvrojë një sasi kontraktuale të mbeturinave urbane të pranueshme dhe do të paguajë shoqërinë për depozitimin e këtyre mbeturinave.

4- Kontratë Shërbimi datë 18.04.2017 lidhur ndërmjet shoqëria Ndërkomunale Bushat sha në cilësinë e porositesit dhe shoqëria Becker Albania sha në cilësinë e operatorit me objekt: Objekti i kësaj kontrate është përcaktimi i kushteve midis palëve për dhënie në përdorim të landfillit të bushatit, operatorit dhe realizimit prej tij të shërbimeve të depozitimit, administrimit, menaxhimit, përpunimit dhe riciklimit të mbetjeve të ngurta urbane në landfillin e bushatit. Shërbimet e depozitimit, administrimit , menaxhimit përpunimit dhe riciklimit të

mbetjeve të ngurta urbane në landfillin e bushatit merren përsipër të kryhen prej operatorit në përmbushje të kushteve të kësaj kontrate.

5- Leje Mjedisore Kodi III.1.B për aktivitetin e funksionimit të vendepozitimit të mbetjeve urbane në emër të Becker Albania. Akt Miratimi Leje Mjedisore Nr.7185/4 datë 15.12.2010.

6- Mandat pagese datë 30.09.2019, me objekt likuidim faturash, kryer nga “Vale Recycling” shpk, në favor të “Ndërkomunale Bushat” sh.a.

III.1.3. Ndërsa në nenin 26, pika 5 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, përcaktohet se: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.

III.1.4. Në nenin 46 pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.” b) “aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.”.

III.1.5. Në nenin 55, pika 2 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: 2. Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit.

III.1.6. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe

kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kapaciteteve të kërkuara në dokumentat e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor, do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit në respekt të nenit 66 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 i ndryshuar. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi. KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.7. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërituar, KPP gjykon se operatori ekonomik “*Vale Recycling*” shpk ka dorëzuar në përputhje me kriterin kualifikues dokumentacion lidhur me një landfill të licensuar nga organet kompetente shtetërore, për depozitimin e produktit final që del nga përpunimi i mbetjeve spitalore. KPP gjykon se operatori ekonomik ka përmbushur kërkesat e parashikuara në kriterin e vecantë të kualifikimit pika 2.3.5 kapaciteti teknik, duke dëshmuar se disponon një landfill në një nga format e lejuara ligjore për depozitimin e produktit final. Gjithashtu për sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nga ana e autoritetit kontraktor, në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, është kërkuar si kriter kualifikimi që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurë duhet të paraqesin *a) kontratën me landfillin e licensuar ose faturat e lëshuara nga landfilli për vitin 2019., b) pagesën e kryer ndaj landfillit ku depoziton mbetjet nga aktiviteti për vitin 2019*, kriteret këto të përmbushura me sukses nga ana e operatorit ekonomik ankimes, ndaj çdo kërkesë apo pretendim tjetër i ngritur nga autoriteti kontraktor përtej kriterit të mësipërcituar nuk përbën detyrim ligjor për tu përmbushur nga ofertuesit, sic parashikohet në nenin 46 dhe 55/2 si më sipër cituar.

Komisioni i Prokurimit Publik rithekson se, autoritetet kontraktore duhet të përcaktojnë dokumentat konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e kriterëve, si dhe nuk duhet të përdorin kriteret që nuk janë të përcaktuara në dokumentat e tenderit të procedurës përkatëse të prokurimit. Në mënyrë eksplicite ligji për prokurimin publik parashikon se vlerësimi i ofertave duhet bërë vetëm në përputhje me kriteret e kualifikimit të

parashikuara në dokumentet e procedurës përkatëse. Vlerësimi i ofertave referuar kritereve të tjera të kualifikimit të cilat në asnjë rast nuk janë parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit jo vetëm që është në kundërshtim me nenin 55 pika 2 e LPP-së, si më sipër cituar, por cënon gjithashtu parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit, parashikuar nga neni 2 i lex specialis, atë të barazisë në trajtimin e kërkesave dhe detyrimeve që i ngarkohen ofertuesve.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik “Vale Recycling” shpk qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr.596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Vale Recycling” sh.p.k për procedurën e prokurimit *Kërkesë për Propozim*” me Nr. REF-49691-02-06-2020, me objekt: “*Sherbimi i Evadimit të mbetjeve të rrezikshme spitalore për Spitalin Sarandë, për 12 muaj*”, me fond limit 1,750,000 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 17.02.2020, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Sarandë.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik ankimues “Vale Recycling” shpk duke e kualifikuar atë.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Vale Recycling” shpk.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Nr. 308 Protokoli, Datë 17.03.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

NënKryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha